

UDHERREFYES

Mbi Rregullat e Origjines Preferenciale te perdorura ne tregtine ndermjet Shqiperise dhe Vendeve te tjera sipas Marreveshjeve te Tregtise se Lire.

PARATHENIE

Qellimi i ketij Udherrefyesi eshte te mundesoje shpjegime per punonjesit e doganes, axhentet doganore, operatoret ekonomike e tregtare, studentet apo per kedo tjetër qe ka nevoje per informacion, mbi Rregullat e Origjines Preferenciale qe jane duke u perdorur ne tregtine ndermjet Shqiperise dhe vendeve te tjera ne kuadrin e Marrveshjes se Stabilizim Asociimit me Bashkimin Europian, Marrveshjes CEFTA 2006 (Kosova, Maqedonia, Mali I Zi, Serbia, Kroacia, Moldavia, Bosnje-Hercegovina), Marrveshjes se Tregtise se Lire me Turqine, Marrveshjes EFTA (Zvicër, Norvegji, Islande, Lehtenshtein).

Pjese te ketij Udherrefyesi mund te permbajne informacion te njohur nderkohe per shume nga perdoruesit e tij, por ky informacion mund te jete teresisht i panjohur per shume te tjere. Gjithsesi, informacionet e marra do te jene te dobishme dhe pergjithesisht informuese per kedo qe do te kete nevoje te konsultohet me to.

Udherrefyesi eshte i ndare ne dy pjese. Pjese e pare trajton pyetje dhe parime baze te origjines ndersa pjese e dyte perqendrohet ne shpjegimin e dispozitave te Protokolleve te Origjines sipas Marrveshjeve te Tregtise se Lire.

INFORMACION I PERGJITHESHEM

Sistemi i Rregullave Preferenciale te Origjines te pershkruara ne kete Udherrefyes bazohet ne dispozitat ligjore te Marrveshjes se Stabilizim Asociimit, Marrveshjes CEFTA 2006, Marrveshjes se Tregtise se Lire me Turqine dhe Marrveshjes EFTA. Ne te ardhmen mund te konkludohen marrveshje te tjera te Tregtise se Lire.

Shembujt e perdorur jane thjesht ilustrues dhe kane per qellim te tregojne menyren e funksionimit te sistemit te origjines preferenciale ne terma praktike.

Protikolli i perdorur ne kete Udherrefyes eshte protokolli 4 i Marrveshjes se Stabilizim Asociimit ndermjet Shqiperise dhe Bashkimit European, titulluar

“PERKUFIZIMI I KONCEPTIT “PRODUKTE ORIGJINUESE” DHE METODAT E BASHKEPUNIMIT ADMINISTRATIV PER ZBATIMIN E DISPOZITAVE TE KESAJ MARREVESHJEJE” NDERMJET KOMUNITETIT DHE REPUBLIKES SE SHQIPERISE”

PJESA 1

**INFORMACION LIDHUR ME KONCEPTIN E
PRODUKTEVE ORIGJINUESE.**

CFARE ESHTE ORIGJINA

E thene thjesht, origjina eshte kombesia “ekonomike” e mallrave qe tregtohen. Eshte e nevojshme te percaktohet origjina dhe klasifikimi tarifor i mallrave ne menyre qe te kemi mundesi te llogarisim taksen doganore qe aplikohen mbi mallin. Ka dy lloje origjinash, jo-prefenciale dhe preferenciale dhe trajtimi doganor i mallrave ne import varet nga origjina qe ato kane.

CFARE ESHTE ORIGJINA JO-PREFERENCIALE

Origjina jo-prefenciale thjesht i jep nje kombesi “ekonomike” mallrave dhe nuk sjell ndonje pertifim per to. Origjina jo-prefenciale perfitohet ose ne rastin e mallrave “teresisht te prodhuara” (Koncepti i mallrave “teresisht te prodhuara” eshte shpjeguar tek pershkrimi i Nenit 5) ne nje vend ose, kur dy apo me shume vende jane perfshire ne prodhimin e nje produkti. Origjina qe merret eshte ajo e vendit ku eshte kryer prodhimi apo perpunimi i fundit thelbesor, ekonomikisht i justifikuar. Origjina jo-prefenciale perdoret per shembull, per te percaktuar nese mallrat kushtezohen apo jo nga masa anti-dumping apo kufizime sasiore, si dhe per qellime statistikore. Gjithashtu mund te perdoret per te percaktuar origjinen ne kontekstin e “shenimit te origjines” (p.sh etiketa “Made in....”) tek mallrat.

CFARE ESHTE ORIGJINA PREFERENCIALE

Mallrat marrin **Origjinen Preferenciale te vendeve te caktuara** kur ato kane permbushur kriteret e parashikuara. Kriteri i Origjines Preferenciale ne pergjithesi kerkon qe mallrat te kalojne nen me shume punime apo perpunime sesa ato qe kerkohen per te marre origjinen jo-prefenciale. Gjithsesi, mallrat teresisht te prodhuara (shih shpjegimet per Nenin 5) mundet gjithashtu te perfitojne nga statusi i origjines preferenciale. Origjina preferenciale u jep disa perfitime mallrave te tregtuara ndermjet vendesh te ndryshme te cilat kane nje Marreveshje ndermjet tyre, zakonisht ky perfitim eshte tarife doganore zero, tarife e reduktuar ose tarife zero Brenda sasive te caktuara (kuota).

A MUND TE PERFITOJNE TE GJITHA MALLRAT NGA ORIGJINA PREFERENCIALE?

Teorikisht te gjithe mallrat mund te perfitojne nga origjina preferenciale. Ne realitet, nje vend nuk do te jape preference per mallrat te cilat i konsideron se jane sensitive per industrite e veta

dhe kështu, keto çështje diskutohen ndërmjet paleve gjatë negociatave përpara konkludimit të Marrëveshjes. Kështu që është e nevojshme paraprakisht të konsultohemi me MTL-ne përkatëse ndërmjet vendit eksportues dhe vendit importues për të parë nëse mallrat janë në listën e atyre që përfitojnë nga Marrëveshja.

KU MUND TË GJEJ NESE MALLRAT KUALIFIKOHEN PËR TRAJTIM PREFERENCIAL?

Me qellim që të kënaq origjinë preferenciale, mallrat duhet të plotësojnë kushtet e Protokollit të Origjinës që ka të bëjë me perkufizimin e “produkteve origjinuese”. Kjo do të thotë se mallrat ose duhet të jenë teresisht të përftuara, sipas Nenit 5 ose të kënaq kaluar nën një përpunim të caktuar. Bashkëngjitur me çdo Protokoll Origjinë ekziston si Aneksi, një listë e punimeve apo përpunimeve nga të cilat duhet të kënaq kaluar produkti në mënyrë që të përfitojë preferencë.

Kjo listë bazohet në klasifikimin tarifor të mallrave sipas Sistemit të Harmonizuar (HS). Kështu, përpara se të kënaq mundësinë të përcaktojmë se në çfarë përpunimesh duhet të kënaq kaluar produkti në mënyrë që të përfitojë origjinën preferenciale, është e domosdoshme që të dime klasifikimin tarifor HS.

ÇFARË ËSHTË KLASIFIKIMI TARIFOR?

Megjithatë klasifikimi tarifor është në vetvete një fushë shumë e specializuar e doganës, është e nevojshme të bëjmë këtu një përkrahim shumë të shkurtër të tij. Klasifikimi tarifor rrjedh nga një sistem i cili është projektuar për të identifikuar çdo mall që tregtohet, që mund të jetë e thjeshtë si argjila për të bërë pllakë, e deri tek pajisjet më të sofistikuar mjeksore të fjalës së fundit. Me qellim që të arrihet kjo gjë, çdo produkti I duhet dhënë një kohë tarifor.

Kodet Tarifore listohen në tarifën kombëtare të çdo vendi. Në rastin tonë sistemi i klasifikimit bazohet në Përkrahimin e Harmonizuar të Mallrave dhe Sistemin e Kodimit, të njohur si “Sistemi I Harmonizuar” ose “HS”. HS është ndarë në 97 “Kapituj” të cilët janë ndarë më tej në “Krere” të katër shifrore.

Bazuar në klasifikimin e vet tarifor në kombinim me origjinën, mund të përcaktohet për çdo mall taksa doganore, kuota tarifore etj.

Në kuadrin e origjinës preferenciale, është thelbësorë të dihet kreu i saktë tarifor, pasi punimi apo përpunimi i nevojshëm për t’i dhënë mallit origjinë preferenciale bazohet gjithashtu në sistemin HS.

Eshte pra e domosdoshme te dihet kodi tarifor i mallit, perndryshe mund te dalin problem dhe veshtiresi per eksportuesin/importuesin, lidhur me origjinen e mallit.

CFARE ESHTË KUMULIMI

Aneksi i Protokollit te Origjines (“Aneksi II”) qe paraqet proceset e kerkuara per te perftuar origjinen pershkruan se cfare duhet bere mbi nje product ne menyre qe ai te perfitoje nga origjina preferenciale. Gjithsesi, ne manifakturimin modern eshte mese e zakonshme qe dy apo tre burime ne vende te ndryshme te perfshihen ne prodhimin e nje produkti final. Ne rastet kur dy apo me shume vende kane rregulla te njejta origjine dhe kane me njera- tjetren nje Marreveshje te Tregtise se Lire, ato mundet te **kumulojne origjine.**

Ne konteksin e MTL-ve ne fuqi, kumulim do te thote se produktet qe kane perftuar statusin origjinues ne nje vend partner mund te perdoren me produkte qe kane origjinuar ne nje vend tjetër partner, pa u paragjykuar statusi i origjines preferenciale te produktit final.

Ne rastin e kumulimit, mbi produktet origjinuese ne secilin vend partner, nuk eshte e nevojshme te “punohet apo perpunohet ne menyre te mjaftueshme”, sipas kuptimit te Nenit 6, me qellim qe produkti final te perfitoje origjinen e vendit partner, por duhet te kaloje listen e operacioneve minimale te cilat pershkruhen ne Nenin 7.

Shembull 1:

Nje produkt, teresisht i perftuar ne Bashkimin europian dergohet ne Zvicer ku perpunohet me tej. Produkti final do te kete Origjine Zviceriane me kusht qe punimet apo perpunimet e kryera ne Zvicer te jene pertej atyre minimale percaktuar ne Nenin 7. Nese produkti final eksportohet nga Zvicra ne Bashkimin Europian, ky produkt do te konsiderohet me origjine preferenciale Zviceriane.

Shembull 2:


Nje makineri e paperfunduar e cila e ka origjinen ne Bashkimin Europian dergohet ne Shqiperi ku kalon punime apo perpunime te tjera te cilat i tejkalojne operacionet minimale te parashikuara ne Nenin 7. Kjo makineri dergohet me pas ne Malin e Zi ku i nenshtrohet perseri perpunimeve te cilat jane pertej operacioneve minimale te Nenit 7. Makineria e perftuar ka origjine nga Mali i Zi.

Ekzistojne tre lloje kumulimi te pershkruara ne kete Udherrefyese, **Kumulim Bilateral, Kumulim Diagonal dhe Kumulim i Plote.**

CFARE ESHTE KUMULIMI BILATERAL?

Kumulimi Bilateral vepron ndermjet dy partnereve. Kjo do te thote se prodhuesit ne secilin nga dy vendet mund te perdorin material dhe komponente origjinues ne vendin tjetër sikur keto te ishin origjinuese ne vendin e tyre dhe gjithashtu operacionet e kryera ne njerin vend partner mund te bashkohen me operacionet e kryera ne vendin tjetër partner per ti dhene statusin origjinues mallrave te tregtuara ndermjet tyre. (Simboli tregon nje Marreveshje Tregtie te Lire Bilaterale).

Diagram A



Shembull 1:


Pelhura, origjinuese ne BE, eksportohet ne Shqiperi ku pritet dhe nga kjo prodhohen kemisha. Keto kemisha eksportohen ne BE. Per shkakun se pelhura ka origjine BE, kjo trajtohet sit e ishte me origjine Shqiptare kur ne Shqiperi prodhohen kemishat. Kemishat e perfunduara kane origjine preferenciale Shqiptare. (Sipas kumulimit diagonal, kemishat mund te eksportohen gjithashtu me origjine preferenciale Shqiptare ne secilin nga vendet partnere ne kumulimin diagonal.)

CFARE ESHTE KUMULIMI DIAGONAL?

Kumulimi Diagonal vepron ndermjet me shume se dy vendeve. Nese vendet A,B dhe C kane MTL me njera tjetren dhe rregullat e origjines ne keto MTL jane identike, vendi A mund te aplikojë kumulimin diagonal ne tregtine e vet me dy partneret e tjere, nese MTL-te e tyre parashikojne nje kumulim te tille.

Per shembull, produktet origjinuese nga vendet B dhe C mund te perdoren per te prodhuar nje produkt origjinues ne Vending A. Importet ne vendin A nga vendet B dhe C zhvillohen nen MTL-te elzistuese ndermjet vendit A dhe dy vendeve te tjera. Per shkak se te tre vendet funksionojne me sisteme identike te rregullave te origjines, statusi origjinues i te gjithe komponenteve mund te shtohet ndaj njera-tjetres per ti dhene statusin origjinues produktit final. Kjo gje ilustruhet nepermjet diagramin B, me poshte.

Diagram B



Nga diagram eshte e qarte se tre vendet ne transaksion jane te lidhura se bashku nga MTL (te treguara nepermjet simboleve (↔↔↔

dhe↕↕) ndermjet tyre. Secili vend duhet te kete rregulla origjine identike me secilin prej dy vendeve te tjera. Nuk mjafton qe vendi A te zbatoje rregulla identike origjine me dy vendet e tjera, ato gjithashtu qe te treja duhet te zbatojne te njejtat rregulla origjine ndermjet njera-tjetres. **NJE VEND MUND TE ZBATOJE KUMULIMIN ME ATO VENDE ME TE CILAT KA NJE PROTOKOLL ORIGJINE I CILI PARASHIKON NJE KUMULIM TE TILLE DHE QE PERMBAN RREGULLA IDENTIKE ORIGJINE.**

Shembull:

Shqiperia ka MTL me Bashkimin European dhe me Maqedonine te cilat parashikojne kumulim dhe permbajne rregulla identike origjine. Bosnje-Hercegovina ka gjithashtu marrveshje te tilla.

Ne kete menyre, Shqiperia mund te perdore produkte origjinuese nga Bashkimi European dhe nga Maqedonia, per te eksportuar ne Bosnje-Hercegovine nje produkt me origjine preferenciale Shqiptare.

CFARE ESHTË KUMULIMI I PLOTE?

Ne konteksin e kumulimit “Pan-European” kumulimi i plote funksionon vetem ndermjet partnereve te Zones Ekonomike Europiane (EEA). Bazuar ne disa protokolle funksionon edhe me Tunizine, Marokun dhe Algjerine.

CFARE ESHTË KUMULIMI PAN-EURO-MEDITERRANEAN?

Kumulimi Pan-Euro_Mediterranean eshte termi i perdorur per te pershkruar sistemin e kumulimit diagonal ne operacionet ndermjet Bashkimit European dhe nje numri vendesh Europiane dhe Mesdhetare.

Vendet qe aplikojne Kumulimin PAN-EURO-MEDITERRANEAN jane Shtetet Anetare te Bashkimit European, Islanda, Leichtensteini, Norvegjia, Zvicra, Turqia, Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordania, Libani, Maroku, Tunizia, Autoritetet Palestineze te Rripit te Gazes dhe Bregut Perendimor.

BE ka Union Doganor me Turqine, Principaten e Andores dhe Republikën e San-Marinos.

KU MUND TE GJENDEN PROTOKOLLET E RREGULLAVE TE ORIGJINES?

Protokollet e Origjines per cdo Marrveshje te Tregtise se Lire ndermjet Shqiperise dhe vendeve te tjera jane te publikuara ne Fletoret Zyrtare per keto MTL si dhe ne faqen zyrtare elektronike te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave www.dogana.gov.al/origjina.

PJESA 2

ANALIZE E PROTOKOLLIT TE ORIGJINES

HYRJE

Pjesa 2 e ketij Idherrefyesi mundeson nje ekzaminim dhe shpjegim te Protokolleve te Origjines te Marrveshjeve te Tregtise se Lire ne fuqi ndermjet Shqiperise dhe vendeve/grup vendeve te tjera.

Kjo analize eshte bere Nen pas Neni. Ne fillim eshte paraqitur Neni dhe me pas behet nje shpjegim i tij dhe kur eshte pare e nevojshme paraqiten dhe shembuj.

STRUKTURA E PROTOKOLLEVE TE ORIGJINES

Protokolli eshte ndare ne Tete Seksione te quajura “Tituj”. Titujt mbulojne te gjitha aspektet e sistemit te origjines qe jane ne zbatim. Disa nga Titujt me te rendesishem jane si me poshte:

Titulli I	Dispozita te Pergjithshme
Titulli II	Perkufizimi i konceptit “produkte origjinuese”
Titulli III	Kerkesat Territoriale
Titulli IV	Riimbursimi ose perjashtimi
Titulli V	Vertetimi i Origjines
Titulli VI	Regullime per Bashkepunimin Administrativ
Titulli VIII	Dispozita Finale

Secili Titull permban nje numer Nenes, secili prej te cileve mbulon nje aspect specific te Protokollit. Kjo pjese e Udherrfyesit do te shpjegoje sistemin e origjines duke ju referuar Titujve dhe Neneve sipas rradhes.

Titulli I

Dispozita te Pergjithshme

Titulli I mbulon vetem nje Nen. Ky Nen paraqet perkufizimet juridike te termave te ndryshem te paraqitur ne Protokoll. Perkufizimet e Nenit 1 jane perkufizime juridike dhe jo perkufizime sipas fjalorit te gjuhes.

NENI 1

Perkufizimet

Per qellime te ketij protokolli:

- (a) “prodhim” do te thote cdo lloj punimi ose procesi duke perfshire operacione bashkimi ose specifike;*
- (b) “material” do te thote cdo lloj perberesi, lende e pare, perberes ose pjese, etj., te perdorura ne prodhimin e produktit;*
- (c) “produkt” do te thote produkti qe eshte perpunuar, edhe nese ai eshte per t’u perdorur me vone ne nje proces tjeter prodhimi;*
- (d) “mallra” perfshin se bashku, materialet dhe produktet;*
- (e) “vlere doganore” do te thote vlere e percaktuar ne perputhje me Marreveshjen mbi Zbatimin e Nenit VII te Marreveshjes se Pergjithshme mbi Tarifat dhe Tregtine GATT 1994 (Marreveshja e OBT-se per Vleresimin Doganor);*
- (f) “cmimi ex-works” do te thote cmimi i paguar per produktin ex-works tek prodhuesit e produktit ne Komunitet ose ne Shqiperi ne te cilen ndermerret procesi apo puna perfundimtare, qe siguron cmimin qe perfshin vleren e te gjithe materialeve te perdorura, minus taksat e brendshme te cilat jane, ose mund te jene shlyer kur produkti i perftuar eksportohet;*

- (g) “vlera e materialeve” do te thote vlera doganore ne kohen e importimit te materialeve te perdorura jo-origjinuese, ose, nese kjo nuk eshte e njohur dhe nuk mund te percaktohet, cmimi i pare i percaktuar i paguar per materialet ne Komunitet dhe Shqiperi;
- (h) “vlera e materialeve origjinuese” do te thote vlera e materialeve te tilla sic eshte percaktuar ne nenparagrafin (g) te aplikuar mutatis mutandis;
- (i) “vlera shtese” merret nga cmimi ex-works minus vleren doganore te secilit nga materialet e perfshira, te krijuar ne Palen tjeter Kontraktuese ose, kur vlera doganore nuk eshte e njohur ose nuk mund te jete e vertetuar, cmimi i pare i vertetuar i paguar per materialet ne Komunitet ose ne Shqiperi;
- (j) “kapituj” dhe “kreret” do te thote kapitujt dhe kreret (kodet kater-shifrore) te perdorura ne nomenklature te cilat perbejne Pershkrimin e Harmonizuar te Mallrave dhe Sistemin e Kodeve, referuar ne kete protokoll si “Sistemi i Harmonizuar” ose “HS”;
- (k) “i klasifikuar” i referohet klasifikimit te nje produkti ose materiali nen nje kre te vecante;
- (l) “dergesa” do te thote produkte qe jane derguar ne menyre te njekohshme nga nje eksportues te nje marres ose te shoqeruara me nje dokument te vetem transporti qe mbulon transportimin e tyre nga nje eksportues te nje marres ose, ne mungese te nje dokumenti te tille, nga nje fature e vetme;
- (m) “territore” perfshijne edhe ujrat territoriale.

KOMENTE:

Neni 1 percakton kuptimin juridik te termave te perdorura ne Protokoll.

Neni 1(k) i referohet klasifikimit te nje produkti apo materiali nen nje kre perkates te Sistemit te Harmonizuar.

Perkufizimet e perdorura jane te njejta ne te gjitha Protokollat e Rregullave te Origjines.

Titulli II

Perkufizimi i konceptit te “produkteve origjinuese”

Ne vazhdim te terminologjise se perdorur ne Protokolle, Titulli II vazhdon, ne hapesiren e 10 Neneve, te perkufizoje konceptin e origjines preferenciale ne kontekstin e marreveshjeve.

Sic u permend tek parathenia, nenet ndjekin nje progresion logjik duke filluar me elementet baze dhe duke vazhduar me tej me koncepte me komplekse. Per shembull Nenet 3 dhe 4 trajtojne kumulimin (kumulimin bilateral dhe kumulimin diagonal) ndersa Nenet 5 dhe 6 trajtojne menytrat sesi mallrat mund te perfitojne origjinen preferenciale. Keshtu koncepti shpjegohet dhe me pas deklarohet se si mund te merret origjina.

Pra, fillimisht si nje rregull i pergjithshem, duhet bere percaktimi nese mallrat jane teresisht te perftuara apo ne to jane trupezuar materiale jo-origjinuese dhe nese keto materiale kane kaluar punime apo perpunime te mjaftueshme per te permbushur rregullat perkatese te listes se proceseve te perpunimit (rregullat e listes).

NENI 2

Kerkesa te pergjithshme

1. Per qellime te zbatimit te kesaj Marreveshjeje, produktet e meposhtme konsiderohen si origjinuese ne Komunitet:

(a) Produktet teresisht te perftuara ne Komunitet ne perputhje me kuptimin e Nenit 5;

(b) Produkte te perftuara ne Komunitet qe perfshijne materiale qe nuk kane qene teresisht te perftuara atje, me kusht qe materiale te tilla te kene kaluar ne punime apo procese te mjaftueshme ne Komunitet ne perputhje me Nenin 6;

2. Per qellime te zbatimit te kesaj Marreveshjeje, produktet e meposhtme do te konsiderohen si origjinuese ne Shqiperi:

(a) Produktet teresisht te perftuara ne Shqiperi ne perputhje me kuptimin e Nenit 5;

(b) Produkte te perftuara ne Shqiperi qe perfshijne materiale qe nuk kane qene teresisht te perftuara atje, me kusht qe materiale te tilla te kene kaluar ne punime apo procese te mjaftueshme ne Shqiperi ne perputhje me Nenin 6.

KOMENTE:

Ky Nen percakton kriteret qe duhen aplikuar mbi mallrat ne menyre qe ato te konsiderohen si origjinuese ne Shqiperi, ne BE apo ne vendet partnere.

Neni 2(1)(b) thekson se cdo lloj materiali jo-origjinues i perdorur ne prodhimin e produkteve origjinuese duhet te kete kaluar punime apo perpunime te mjaftueshme ne vendin e manufakturimit. Kjo do te thote qe materialet jo-origjinuese mund te perdoren ne Shqiperi apo ne BE per te prodhuar nje material origjinues me kusht qe keto materiale te kalojne punim apo perpunim te mjaftueshem ne Shqiperi apo ne Bashkimin European.

Kur materialet jo-origjinuese te cilat jane importuar ne Shqiperi apo ne Bashkimin European nuk kalojne nen punime apo perpunime te mjaftueshme, keto materiale ruajne statusin e tyre jo-origjinues dhe nuk mund te perfitojne nga trajtimi preferencial sipas ketyre termave te Protokollit, kur importohet ne nje vend tjetër. Per shembull, nese materialet jo-origjinuese importohen ne Bashkimin European ato duhet te kalojne nen nje punim apo perpunim te mjaftueshem aty qe te marrin origjinen preferenciale. Kur materialet kane perfituar origjinen, ato mund te dergohen tek vendi tjetër partner ku mund te kalojne nen perpunime te tjera dhe perfitojne origjinen preferenciale te atij vendi. Kjo gje shpjegohet me ne detaje ne vazhdim te Udherrefyemit.

PYETJE:

1.SI MUND TA PERFITOJNE MALLRAT ORIGJINEN PREFERENCIALE?

Origjina eshte nenshtetesia ekonomike e nje produkti. Origjina mund te perfitohet ose ne rastin kur mallrat jane teresisht te perftuara (Nenet 2(1)(a) dhe 2(2)(a)) ose nga punime apo perpunime te mjaftueshme (Nenet 2(1)(b) dhe 2(2)(b)).

2.CFARE NENKUPTOHET ME “MALLRA TERESISHT TE PERFTUARA”?

Termi “teresisht te perftuara” mbulon produkte te tilla si prodhime te fresketa p.sh fruta dhe zarzavate te rritura dhe te korrura ne vendin eksportues, ose produkte minerale te nxjerra aty.

Mallrat e prodhuara ne nje vend, teresisht prej produkteve teresisht te prodhuara ne ate vend, jane edhe ato produkte teresisht te perftuara.

Neni 5 shpjegon se cilat produkte mund te konsiderohen si teresisht te perftuara. Me shume te dhena lidhur me kete koncept do te paraqiten ne shpjegimet bashkangjitur Neni 5.

3.CFARE DO TE THOTE MALLRA TE PERPUNUARA APO TE PUNUARA NE MENYRE TE MJAFTUESHME?

Si rezultat i globalizimit dhe i shperndarjes moderne nderkombetare te punes, si dhe per shkak te teknologjive ne zhvillim, shume mallra do te permbajne ne vetvete lende te para, produkte gjysem te gatshme, komponente te tjere etj., nga me shume se nje vend.

Ne raste te tilla, ne menyre qe produkti te perfitoje origjine eshte e nevojshme qe ky i fundit te kete kaluar nje minimum perpunimi apo nje numer perpunimesh gjate stadeve te prodhimit. Operacionet e detyruara apo perpunimet qe kerkohet te kryhen mbi materialet jo origjinuese jane pershkruar qarte ne Nenin 6 dhe ne Kolonat 3 dhe 4 te Aneksit II te Protokolleve te Origjines.

Neni 6 i Protokollit te Origjines trajton punimin apo perpunimin e mjaftueshem. Detaje te metejshme lidhur me kete koncept mundesohen tek shpjegimet mbi Nenin 6.

NENI 3

Kumulimi ne Komunitet

1. *Pa cenuar dispozitat e Nenit 2(1), produktet konsiderohen origjinuese ne Komunitet kur keto produkte perftohen atje, duke bashkengjitur materiale origjinuese ne Shqiperi, ne Komunitet, ne cdo vend tjeter apo territor pjesemarres ne procesin e Stabilizim-Asociimit te Bashkimit European ose qe kane bashkengjitur materiale origjinuese ne Turqi per te cilat aplikohet Vendimi Nr. 1/95 i Keshillit te Asociimit KE-Turqi i 22 dhjetorit 1995¹ me kusht qe punimi ose perpunimi i kryer ne Komunitet te shkoje pertej operacioneve te referuara ne Nenin 7. Nuk eshte e nevojshme qe materiale te tilla te kene kaluar punime apo procese te mjaftueshme.*
2. *Kur punimi apo proceset e kryera ne Komunitet nuk shkojne pertej atyre te referuara ne Nenin 7, produkti i perftuar konsiderohet si origjinues ne Komunitet vetem kur vlera shtese eshte me e madhe sesa vlera e materialeve te perdorura ne cilindo prej vendeve te tjera apo territoreve te referuara ne paragrafin 1. Ne rast te kundert, produkti i perftuar konsiderohet si origjinues ne vendin i cili ka vleren me te madhe te materialeve origjinuese te perdorura per perpunim ne Komunitet.*
3. *Produktet origjinuese ne nje prej vendeve apo territoreve te referuara ne paragrafin 1, qe nuk i nenshtrohen ndonje punimi apo procesi ne Komunitet, e ruajne origjinen e tyre nese eksportohen ne nje prej ketyre vendeve apo territoreve.*
4. *Kumulimi i dhene nga ky Nen eshte i zbatueshem vetem kur:*
 - (a) *Nje marreveshje tregtare preferenciale ne pajtim me Nenin XXIV te Marreveshjes se Pergjithshme per Tarifat dhe Tregtine (GATT) eshte e zbatueshme ndermjet vendeve apo territoreve te perfshira ne marrjen e statusit te origjines dhe vendit te destinacionit;*
 - (b) *Materialet dhe produktet kane marre statusin e origjines ne baze te rregullave te origjines identike me ato te dhena ne kete Protokoll; dhe*
 - (c) *Njoftimet qe tregojne permbushjen e kerkesave te nevojshme per aplikim per kumulim jane botuar ne Gazeten Zyrtare te Bashkimit European (seria C) dhe ne Shqiperi sipas procedurave te saj.*

Kumulimi i dhene ne kete Nen eshte i zbatueshem qe nga data e treguar ne njoftimin e botuar ne Fletoren Zyrtare te Bashkimit European (seria C).

Komuniteti i siguron Shqiperise, nepermjet Komisionit te Komuniteteve Europiane, detajet e Marreveshjeve dhe rregullat e origjines perkatese, te cilat jane te zbatueshme me vendet e tjera apo territoret e permendura ne paragrafin 1.

Produktet ne Shtojcen V perjashtohen nga kumulimi i dhene nga ky Nen.

NOTE SHPJEGUESE E BE

Nenet 3 dhe 4 – Kumulimi

Dhenia e origjines

Si koncept i pergjithshem, origjina e produktit final do te percaktohet nepermjet “punimit apo perpunimit te fundit” te kryer, me kusht qe operacionet e kryera te jene pertej atyre te permendura ne Nenin 7.

Nese, ne vendin e perpunimit te fundit, materialet jo-origjinuese nga nje apo me shume vende nuk kalojne ne perpunime apo punime pertej atyre minimale, origjina e produktit final do t'i jepet vendit qe ka kontribuar me vleren me te larte. Per kete qellim, vlera e shtuar ne vendin e perpunimit final – perfshire vleren e materialeve jo-origjinuese te cilat jane perpunuar ne menyre te mjaftueshme – do te krahasohet me vleren e materialeve origjinuese ne secilin prej vendeve te tjere.

Nese ne vendin e eksportit, nuk eshte kryer asnje punim apo perpunim, materialet apo produktet, thjeshte ruajne origjinen e tyre nese eksportohen ne njerin nga vendet partnere.

Gjeometria variable

Kumulimi mund te zbatohet vetem nese vendet e prodhimit final dhe vendet e destinacionit final kane ne fuqi midis tyre Marreveshje te Tregtise se Lire, te cilat permbajne rregulla identike origjine, me te gjitha vendet te cilat kane marre pjese ne fitimin e statusit origjinues, pra me te gjitha vendet nga te cilat kane origjinuar materialet e perdorura. Materialet e perdorura ne nje vend i cili nuk ka MTL me vendet e prodhimit/perpunimit final dhe destinacionit final do te trajtohen si jo-origjinuese.

NENI 4

Kumulimi ne Shqiperi

- 1. Pa cenuar dispozitat e Nenit 2(2), produktet konsiderohen origjinuese ne Shqiperi kur keto produkte perftohen atje, duke bashkengjitur materiale origjinuese ne Komunitet, Shqiperi, ose ne cilindo vend tjeter apo territor pjesemarres ne Procesin e Stabilizim-*

Asociimit² te Bashkimit European ose qe merr bashkengjitur materiale origjinuese ne Turqi per te cilat zbatohet Vendimi Nr. 1/95 i Keshillit te Asociimit KE-Turqi i 22 dhjetorit 1995³, me kusht qe punimi ose perpunimi i kryer ne Shqiperi te shkoje pertej operacioneve te referuara ne Nenin 7. Nuk eshte e nevojshme qe materiale te tilla te kene kaluar punime apo procese te mjaftueshme.

- 2. Kur punimi apo proceset e kryera ne Shqiperi nuk shkojne pertej operacioneve te referuara ne Nenin 7, produkti i perftuar konsiderohet si origjinues ne Shqiperi vetem kur vlera shtese eshte me e madhe sesa vlera e materialeve te perdorura ne cilindo prej vendeve te tjera apo territoreve te referuara ne paragrafin 1. Ne rast te kundert, produkti i perftuar konsiderohet si origjinues ne vendin i cili ka vleren me te madhe te materialeve origjinuese te perdorura per perpunim ne Shqiperi.*
- 3. Produktet origjinuese ne nje prej vendeve apo territoreve te referuara ne paragrafin 1, te cilat nuk i nenshtrohen punimeve apo proceseve ne Shqiperi, e ruajne origjinen e tyre nese eksportohen ne nje nga keto vende apo territore.*
- 4. Kumulimi i dhene nga ky Nen eshte i zbatueshem vetem kur:*
 - (a) Nje marreveshje tregtare preferenciale ne pajtim me Nenin XXIV te Marreveshjes se Pergjithshme per Tarifat dhe Tregtine (GATT) eshte e zbatueshme ndermjet vendeve apo territoreve te perfshira ne marrjen e statusit te origjines dhe vendit te destinacionit;*
 - (b) Materialet dhe produktet kane marre statusin e origjines ne baze te rregullave te origjines identike me ato te dhena ne kete Protokoll; dhe*
 - (c) Njoftimet qe tregojne permbushjen e kerkesave te nevojshme per aplikim per kumulim jane botuar ne Fletoren Zyrtare te Bashkimit European (seria C) dhe ne Shqiperi sipas procedurave te saj.*

Kumulimi i dhene ne kete Nen eshte i zbatueshem qe nga data e treguar ne njoftimin e botuar ne Fletoren Zyrtare te Bashkimit European (seria C).

Shqiperia i siguron Komunitetit nepermjet Komisionit te Komuniteteve Europiane, detajet e Marreveshjeve perfshi datat e hyrjes se tyre ne fuqi, si dhe rregullat e origjines perkatese te zbatueshme me vendet e tjera apo territoret e permendura ne paragrafin 1.

Produktet ne Shtojcen V perjashtohen nga kumulimi i dhene nga ky Nen.

NENI 5

Produktet teresisht te perftuara

1. *Produktet e meposhtme konsiderohet si teresisht te perftuara ne Komunitet ose ne Shqiperi:*

(a) *Produkte minerale te nxjerra nga shtresat e tyre tokesore dhe nentoka ujore e detit;*

(b) *Produktet bimore te korrura atje;*

(c) *Kafshet e gjalla te lindura dhe te rritura atje;*

(d) *Produkte nga kafshet e gjalla te rritura atje;*

(e) *Produkte te perftuara nga gjuetia apo peshkimi te kryera atje;*

(f) *Produkte te peshkimit ose produkte te tjera te marra nga deti jashte ujrave territoriale te Komunitetit ose Shqiperise nga barkat e tyre;*

(g) *Produkte te prodhuara ne bordet e anijeve te tyre fabrike ekskluzivisht nga produktet e referuara ne nenparagrafin (f);*

(h) *Artikujt e perdorur, te mbledhur atje, qe pershtaten vetem per mbulimin e lendeve te para, duke perfshire gomat e perdorura te pershtatshme vetem per ritrajtim ose qe perdoren si mbetje;*

(i) *Mbetje dhe scrape te rezultuara nga operacionet e perpunimit te kryera atje;*

(j) *Produkte te nxjerra nga shtresat ose nenshtresat tokesore ne ujrat detare, jashte ujrave te tyre territoriale, me kusht qe kane te drejten mbi keto shtresa apo nenshtresa;*

(k) *Mallra te prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar ne nenparagrafin nga (a) deri (j).*

2. *Termi “barkat e tyre” dhe “anijet e tyre fabrike” ne paragrafin 1(f) dhe (g) aplikohen vetem per barkat dhe anijet fabrike:*

(a) *Te cilat jane te regjistruara ose te mbajtura ne cilindo nga Shtetet Anetare te Komunitetit apo ne Shqiperi;*

(b) *Te cilat lundrojne nenflamurin e cilitdo Shtet Anetar te Komunitetit apo te Shqiperise;*

(c) *Te cilat jane ne pronesi te mbi te pakten 50 per qind nga nenshtetasit e cilitdo Shteti Anetar ose Shqiperise, ose nga nje shoqeri tregtare me zyrat e saj kryesore ne nje nga keto shtete, menaxheri apo menaxheret e te cileve, Kryetari i Bordit te Drejtoreve ose Bordi Mbikeqyres dhe shumica e anetareve te bordeve te tilla jane nenshtetas te Shteteve*

Antare ose Shqiperise dhe te cilet, ne shtese, ne rastin e bashkepronesise ose shoqerive me pergjegjesi te kufizuar, te pakten gjysma e kapitalit i perket ketyre shteteve ose institucioneve publike apo nenshtetasve te Shteteve te mesiperme;

(d) Pronaret dhe drejtuesit e te cilave jane nenshtetas te cilitdo Shteti Anetar te Komunitetit apo te Shqiperise; dhe

(e) Ne te cilat te pakten 75% e ekuipazhit jane nenshtetas te cilitdo Shtet Anetar te Komunitetit ose te Shqiperise.

KOMENT:

Neni 5 perkufizon per qellimet e Protokollit se cfare nenkupton termi “teresisht te perftuara” dhe liston mallrat e mbuluara nga ky term.

NENI 6

Produkte te punuara ose te perpunuara ne mase te mjaftueshme

1. Per qellime te Nenit 2, produktet te cilat nuk jane teresisht te perftuara konsiderohen te punuara ose te perpunuara mjaftueshem kur jane permbushur kushtet e vendosura ne listen e Shtojces II.

Kushtet e referuara ne paragrafin e mesiperm, per te gjitha produktet qe mbulon kjo Marreveshje, i referohen punimit ose perpunimit qe duhet t'i nenshtrohen materialet jo-origjinuese te perdorura per prodhim dhe jane te zbatueshme vetem ne lidhje me materiale te tilla. Perkatesisht, nese nje produkt i cili e ka marre statusin e origjines duke plotesuar kushtet e vendosura ne liste, eshte perdorur ne prodhimin e nje produkti tjeter, kushtet e zbatueshme ndaj produktit ku eshte bashkengjitur nuk aplikohen per te, dhe nuk do te merren parasysh materialet jo-origjinuese te cilat mund te jene perdorur ne prodhimin e tij.

2. Pavaresht nga paragrafi 1, materialet jo-origjinuese te cilat sipas kushteve te vendosura ne liste nuk duhet te perdoren ne prodhimin e nje produkti, mund edhe te perdoren nese sigurohet qe:

(a) Vlera e tyre totale nuk i kalon 10 per qind te cmimit ex-works te produktit;

(b) Ndonje nga perqindjet e dhena ne liste per maksimumin e vleres se materialeve jo-origjinuese nuk tejkalohen permes aplikimit te ketij paragrafi.

Ky paragraf nuk aplikohet per produktet e renditura nga Kapitulli 50 deri te Kapitulli 63 i Sistemit te Harmonizuar.

3. *Paragrafet 1 dhe 2 aplikohen duke iu nenshtruar dispozitave te Nenit 7.*

KOMENTE:

Me synim qe nje produkt te perfitoje origjine eshte e nevojshme qe te kete kaluar nje perpunim te caktuar apo nje numer perpunimesh gjate stadeve te prodhimit te tij.

Operacionet minimalisht te detyrueshme qe kerkohet te kryhen mbi mallrat jo-origjinuese pershkruhen ne Kolonat 3 dhe 4 te Aneksit II te Protokolleve te Origjines.

Ne shumicen e rasteve, rregulli eshte specifikuar ne kolonen 3. Kur ekziston edhe nje rregull ne kolonen 4, eksportuesi mund te perzgjedhe ndermjet rregullit te kolones 3 ose rregullit te kolones 4. Kur nuk paraqitet asnje rregull ne kolones 4, rregulli qe do te zbatohet eshte rregulli i kolones 3.

Ekzistojne tre kritere qe perdoren ne percaktimin e punimeve apo perpunimeve te mjaftueshme per dhenien e origjines preferenciale:

- a) **Perqindja e vleres se shtuar**, qe do te thote se vlera e materialeve jo-origjinuese nuk duhet te kaloje nje perqindje te caktuar te cmimit ex-works te produktit final;
- b) **Ndryshimi i kreut tarifar**: ku lendet e para jo-origjinuese apo komponentet e perdorur duhet te kene nje kre tarifar HS te ndryshem nga kreu tarifar HS i produktit perfundimtar;
- c) **Rregulla specifike**: kur paraqiten kritere shume specifike.

Shembujt e meposhtem ilustrone konceptin e punimit apo perpunimit te mjaftueshem:

Shembuj:

- a) **Vlera e shtuar:**

Malli: *makineri/pajisje*

Kreu HS *8456 deri 8466*

Rregulli: *'Prodhim ne te cilin vlera e te gjithë materialeve te perdorur nuk e kalon 40% te cmimit ex-works te produktit'*

Shpjegim: Te gjitha materialet **jo-origjinuese** te perdorura ne prodhimin e produkteve si me siper nuk duhet te kene vlere me shume se 40% te cmimit ex-works te produktit te perfunduar. Keshtu, vlera e materialeve origjinuese dhe vlera e punimit apo perpunimit, duke perfshire kostot administrative dhe fitimin, te kryera gjate prodhimit te makinerive/pajisjeve duhet te perbejne te pakten 60% te cmimit ex-works te produktit final.

b) Ndryshimi I kreut tarifor:

Malli: *Produkte qeramike*

Kreu HS Kapitulli 69

Rregulli: *'Prodhim ne te cilin te gjitha materialet e perdorura jane klasifikuar Brenda nje kreu te ndryshem nga ai i produktit final'*

Shpjegim: Kjo thjesht do te thote se te gjitha materialet jo-origjinuese te perdorura per te prodhuar produkte qeramike duhet te vijne nga nje kre i ndryshem nga ai i produktit te perfunduar.

c) Rregulla specifike:

Mallrat: *Pijet, alkoolet dhe uthullat*

HS ex kapitulli 22

Rregulli: *'I gjithe rrushi apo cdo nenprodukt rrushi I perdorur duhet te jete teresisht origjinues'*

Shpjegim: Ky rregull kerkon qe i gjithe rrushi i perdorur per prodhimin e veres te jete i prodhuar ne vend.

Malli: *Kemisha*

Kreu HS ex-kapitulli 62

Rregulli: *'Prodhim nga filli'*

Shpjegim: Me qellim qe kemishat te marrin origjine, prodhimi duhet te filloje nga filli.

Nje ekzaminim i Aneksit II tregon se ka disa kushte te cilat jane bashkim i tre kategorive te rregullave te pershkruara me siper.

Ne rastet kur ne kolonen tre ka me shume se nje kriter per perfitimin e origjines, te gjitha kriteret duhen plotesuar.

SI DUHET LEXUAR ANEKSI II?

Perpara se te fillohet leximi i Aneksit II, eshte e keshillueshme te lexohet Aneksi I ku paraqiten notat shpjeguese per Aneksin II. Keto nota shpjegojne se si duhet lexuar Aneksi II dhe per disa raste mundesohen edhe shembuj.

Operacionet e listuara jane ato minimalet te cilat duhet te kryhen mbi mallrat ne menyre qe te perfitohet origjina. Perpunimi mund te filloje ne nje stad edhe me te hershem, por asnjehere ne nje stad me te vonshem.

NENI 7

Punimet ose perpunimet e pamjaftueshme

- 1. Pa cenuar paragrafin 2, operacionet e meposhtme konsiderohen si punime ose perpunime te pamjaftueshme per t'i dhene statusin e origjines produktit, pavaresisht nese jane plotesuar apo jo kerkesat e Nenit 6:*
 - (a) Kryerja e operacioneve per te siguruar mbajtjen e produktit ne kushte te mira gjate transportit dhe magazinimit;*
 - (b) Thyerjet dhe bashkimet e paketimeve;*
 - (c) Larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksideve, vajit, njollave apo mbulimeve te tjera;*
 - (d) Hekurosja ose presimi i tekstileve;*
 - (e) Operacionet e thjeshta te lysterjeve apo shkelqimit;*
 - (f) Tharja, zbardhimi i pjesshem ose i pergjithshem, shkelqimi dhe ndricimi i farerave dhe orizit;*
 - (g) Operacionet e ngjyrosjes se sheqerit ose dhenia e formave te ndryshme sheqerit;*
 - (h) Qerimi, pastrimi i pjeses se brendshme te frutave, arrave dhe perimeve;*
 - (i) Ndarjet, bluarjet ose prerjet e thjeshta;*
 - (j) Heqja e pjeseve mbuluese, mbrojtja nga demtuesit e jashtem, perzgjedhjet, klasifikimi, pershkallezimet dhe matjet (duke perfshire vendosjen e pjeseve te artikujuve);*
 - (k) Thjesht vendosjet ne shishe, kanace, epruveta, canta, valixhe, kuti, sirtare, fiksimi ne to i letrave ose mbeshjtjellesve si dhe te gjithe operacionet e tjera te paketimit te thjeshte;*
 - (l) Fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove si dhe i shenjave te tjera te dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;*
 - (m) Perzjerje e thjeshte e produkteve, te llojeve te ndryshme apo jo, perzjerja e sheqerit me cfaredo materiali tjetër;*

- (n) *Bashkimi i thjeshte i pjeseve te artikujve per te perfunduar nje material te plote ose ndarja e produktit ne pjese;*
- (o) *Kombinimi i dy ose me shume operacioneve te specifikuara ne nenparagrafet nga (a) ne (n);*
- (p) *Therja e kafsheve.*
2. *Te gjitha operacionet qe kryhen ne Komunitet ose Shqiperi ne nje produkt te caktuar konsiderohen se bashku ne rastet kur duhet percaktuar nese punimet ose proceset perpunuese mbi te cilat ka kaluar produkti jane te pamjaftueshme brenda kuptimit te paragrafit 1.*

KOMENT:

Ashtu sic ekzistojne “punime apo perpunime te mjaftueshme” ekziston gjithashtu edhe e kunderta, “punime apo perpunime te pamjaftueshme” shpesh te quajtura si “perpunime minimale” apo “operacione minimale”. Disa perpunime konsiderohen se kane nje efekt kaq minimal tek produkti i perfunduar saqe ato asnjehere nuk mund te konsiderohen se mund te ndryshojne origjinen, si ne rastin e nje operacioni te vetem ashtu dhe ne rastin e kombinimit te disa proceseve. E thene thjesht, keto operacione pengojne marrjen e origjines; ne kontekstin e kumulimit keto perpunime nuk i japin mallit origjinen e vendit ku jane kryer.

Shembull:

Kafeja kokerr importohet ne BE nga Kolumbia. Ne BE kjo pastrohet, ndahet dhe vendoset ne paketime te ndryshme. Duke qene se as pastrimi (shpluhurosja) dhe as ripaketimi nuk jane operacione te mjaftueshme per te dhene origjinen, kafeja mban origjinen Kolumbiane.

NENI 11

Elementet neutrale

Me qellim per te percaktuar nese nje produkt eshte origjinues, nuk eshte e nevojshme te percaktohet origjina e zerave te meposhtem te cilet mund te jene perdorur per prodhimin e produktit ne fjale:

- (a) *Energjia elektrike dhe karburanti;*
- (b) *Toka dhe pajisjet;*
- (c) *Makinerite dhe veglat;*
- (d) *Mallrat te cilat nuk hyjne dhe nuk synohen te perfshihen ne perberjen finale te produktit.*

KOMENT:

Termi “elemente neutrale” mbulon ato elemente te cilat nuk jane pjese integrale e produktit te perfunduar. Per kete arsye, nuk do te merren ne konsiderate origjina e karburanteve, makinerive, pajisjeve apo energjise se perdorur per funksionimin e tyre, makinerite robot etj. te perdorura gjate prodhimit.

Shembull:

Turbinat e avullit te kreut HS 8406 jane prodhuar ne BE nga material origjinues dhe jo-origjinues. Turbinat jane prodhuar duke perdorur nje fabrike me pajisje japoneze. Rregulli specifik ne menyre qe turbina te marre origjine preferenciale BE eshte qe materialet jo-origjinuese duhet te kene vlere jo me shume se 40% te cmimit ex-works te produktit final.

Ne perllogaritet nese eshte permbushur kushti 40% per materialet jo-origjinuese, prodhuesi nuk eshte e nevojshme qe te shtoje elemente ne kosto qe kane te bejne me pajisjet japoneze te fabrikes.

Titulli III

Kerkesat Territoriale

Tre Nenet e metejshme perbejne Titullin III te Protokollit. Ato kane te bejne me parimin e territorialitetit, transportin direkt nga nje vend ne nje tjetër dhe rregullat specifike qe kane te bejne me ekspozitat.

Eshte e rendesishme te theksohet se, ndersa Nenet 12 dhe 13 qe te dyja kane te bejne me mallra qe dalin dhe hyjne ne nje zone, ekziston nje ndryshim i qarte ndermjet tyre.

- Neni 12 trajton situaten kur mallrat dalin nga territori i vendit eksportues, per perpunim te metejshem ose jo, dhe me pas kthehen perseri ne vendin eksportues;
- Neni 13 mbulon rastet kur mallrat transportohen nga njera pale ne palen tjetër duke kaluar tranzit neper territorin e nje apo me shume vendeve te tjera.

NENI 12

Parimi i territorialitetit

1. Komuniteti ose Shqiperia duhet te plotesojne pa nderprerje kushtet per perfitimin e statusit origjinues te percaktuara ne Titullin II, me perjashtim te rasteve te referuara ne Nenet 3 dhe 4 te kesaj Shtojce.

2. *Me perjashtim te rasteve te referuara ne Nenet 3 dhe 4, kur mallrat origjinuese te eksportuara nga Komuniteti apo Shqiperia ne nje vend tjeter kthehen, ato konsiderohen jo-origjinuese, pervec rasteve kur autoriteteve doganore u demonstrohet ne menyre te mjaftueshme se:*
 - (a) *Mallrat e kthyer jane po ato qe jane eksportuar; dhe*
 - (b) *Mallrat nuk i jane nenshtruar ndonje procesi pervec atyre te nevojshme per t'i ruajtur ato ne kushte te mira gjate kohes qe kane ndenjur ne ate vend ose gjate eksportimit.*
3. *Perfitimi i statusit origjinues ne perputhje me kushtet e percaktuara ne Titullin II, nuk ndikohet nga punime apo procese te kryera jashte Komunitetit ose Shqiperise ndaj materialeve te eksportuara nga Komuniteti ose Shqiperia dhe ri-importuar atje, duke siguruar qe:*
 - (a) *Materialet ne fjale jane plotesisht te perftuara ne Komunitet ose Shqiperi, ose qe punimet apo perpunimet pertej operacioneve te referuara ne Nenin 7 jane kryer para se te ishin eksportuar; dhe*
 - (b) *Te binden autoritetet doganore se:*
 - i) *Mallrat e ri-importuara kane qene perftuar nga punime apo procese te materialeve te eksportuara; dhe*
 - ii) *Vlera totale shtese e perftuar jashte Komunitetit ose Shqiperise sipas zbatimit te dispozitave te ketij Neni, nuk kalon 10 per qind te cmimit ex-works te produktit perfundimtar per te cilin eshte kerkuar statusi origjinues.*
4. *Per qellime te paragrafit 3, kushtet per perfitimin e statusit origjinues percaktuar ne Titullin II nuk zbatohen per punime apo procese te bera jashte Komunitetit ose Shqiperise. Ne rastet kur, ne listen e Shtojces II, nje rregull i caktuar per vleren maksimale te te gjitha materialeve te bashkengjitura jo-origjinuese zbatohet per percaktimin e statusit te origjines se produktit perfundimtar, vlera totale e materialeve jo-origjinuese te bashkengjitura ne territorin e Pales se interesuar, marre se bashku me vleren totale shtese te perftuar jashte Komunitetit ose Shqiperise sipas zbatimit te dispozitave te ketij Neni, nuk duhet te tejkalojte perqindjen e percaktuar.*
5. *Per qellime te zbatimit te dispozitave te paragrafit 3 dhe 4, "vlera totale shtese" merret ne kuptimin e te gjitha kostove te bera jashte Komunitetit ose Shqiperise, perfshi dhe vleren e materialeve te bashkengjitura atje.*
6. *Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk zbatohen per produktet qe nuk permbushin kushtet e percaktuara ne listen e Shtojces II, ose te cilat mund te konsiderohen te punuara ose*

perpunuara ne mase te mjaftueshme vetem nese zbatohet toleranca e lejueshme e dhene ne Nenin 6 (2).

7. *Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk zbatohen per produktet e kapitujve nga 50 deri ne 63 te Sistemit te Harmonizuar.*
8. *Cfaredo lloj punimi apo procesi qe eshte objekt i dispozitave te ketij Neni dhe eshte kryer jashte Komunitetit ose Shqiperise, behet me ane te marreveshjeve te perpunimit te jashtem (RPP) ose marreveshjeve te ngjashme.*

KOMENT:

Ne Nenet e meparshme u diskutuan te gjitha aspektet fizike mbi percaktimin e origjines se produktit. Neni 12 e kthen vemendjen tek kufizimet gjeografike te vendosura nga rregullat e origjines.

Neni 12(1) specifikon se kushtet e parashtruara ne te gjitha Nenet e Titullit II te Protokollit, me qellim marrjen e origjines, duhet te respektohen.

Neni 12(2) trajton ceshtjen e mallrave origjinuese te cilat dalin nga vendi, dhe per cfaredolloj arsyeje rikthehen. Nese mund te deshmohet derisa autoritetet doganore te binden, se mallrat e rikthyera jane te njejtat mallra te cilat kane dale, dhe gjate periudhes kohore qe kane qendruar jashte vendit asnje veprim nuk eshte kryer mbi to me qellim ndryshimin e tyre, mallrat mund te konsiderohen si origjinuese ne ate vend dhe te rikthehen. Nese nuk mund te vertetohet nje gje e tille, atehere mallrat e rikthyera do te konsiderohen si jo-origjinuese.

Neni 12(3) thekson se pavaresisht paragrafit te mesiperme (2) ekzistojne rrethana te vecanta, nen te cilat mbi mallrat mund te kryhen punime apo perpunime, kur ato ndodhen jashte vendit, punime te cilat nuk i shkaktojne mallit humbjen e statusit te vet origjinues.

Keto kushte jane:

- a) Mallrat qe eksportohen per punime apo perpunime te jene origjinuese;
- b) Duhet te vertetohet se mallrat e ri-importuara jane rezultat i punimeve apo perpunimeve te kryera ne nje vend tjetër mbi mallrat te cilat kane qene eksportuar;
- c) Vlera totale e shtuar jashte vendit nuk i kalon 10% te cmimit ex-works te produktit per te cilin ishte dhene origjina.

Nese nje prej ketyre kushteve te mesiperme nuk plotesohet, atehere mallrat e rikthyera do te konsiderohen si jo-origjinuese.

Dispozitat e ketij Neni nuk zbatohen per produktet e tekstilit te Kapitujve 50 deri 63 (perfshire 63).

NENI 13

Transporti direkt

1. Trajtimi preferencial i siguruar në Marrëveshje aplikohet vetëm për produktet, që plotësojnë kërkesat e këtij Protokolli, të cilat janë transportuar direkt mes Komunitetit dhe Shqipërisë, ose mes shteteve apo territoreve të tjera të përcaktuara në Nenet 3 dhe 4.

Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjerame, nëse çmohet e nevojshme, lëvizje tranzit ose magazinim të përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të qëndrojnë nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të vendit tranzit ose të magazinimit dhe nuk i nënshtohen operacioneve të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit, ose ndonjë operacioni tjetër me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira.

Produktet origjinuese mund të transportohen me anë të tubacioneve përmes territorit por që nuk i përkasin Komunitetit ose Shqipërisë.

2. Prova që vërtetojnë se kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 janë plotësuar tërësisht, duhet t'iu jepen autoriteteve doganore të vendit importues, në formën e :

(a) një dokumenti të vetëm transporti që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit tranzit; ose

(b) një çertifikate të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit tranzit:

(i) ku jepet përshkrim i saktë i produkteve;

(ii) ku paraqiten datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve, ose llojeve të tjera të transportit të përdorur; dhe

(iii) që vërton kushtet nën të cilat kanë qëndruar produktet në vendin tranzit; ose

(c) nëse nuk mundësohen këto dokumenta, ndonjë dokument tjetër thelbësor.

KOMENT:

Qëllimi i Nenit 13 është të sigurojë që, kur mallrat transportohen ndërmjet palëve kontraktuese ato janë të kushtëzuara nga kontrolli doganor.

Llogjika e rregullit të transportit direkt është që të sigurohet se, në parim i gjithë punimi apo përpunimi është kryer brenda vendeve partnere dhe të parandalojë që mallrat e tjera të cilat nuk i plotësojnë kushtet të përfitojnë nga origjina preferenciale. Neni 13 parashtron kushte specifike për të mbuluar situata të tilla.

(a) Rasti i parë ka të bëjë me transportin direkt ndërmjet vendeve fqinje, kur ato kanë një kufi të përbashkët. Një transport i tillë nuk paraqet vështirësi kontrolli, pasi mallrat janë brenda dy vendeve apo nëpër kufijtë e tyre.

(b) Rasti i dytë përfshin transportin indirekt ndërmjet dy vendeve të zonës, duke kaluar teritoresh e vendeve të tjera të zonës brenda së cilës zbatohet kumulimi.

Edhe kjo situatë nuk paraqet problem, pasi transporti kryhet brenda zonës së kumulimit.

(c) Situata e tretë përfshin mallrat të cilat lëvizin ndërmjet dy vendeve, duke kaluar nëpër territorin jashtë zonës së kumulimit. Këto udhëtime mund të përfshijnë kalimin nëpër një apo më shumë vende dhe mund të përfshijnë edhe ndalesa gjatë rrugës.

Në të tilla raste ekzistojnë detyrime strikte për eksportuesin të cilat duhen rrespektuar dhe doganës i duhen dhënë prova dhe fakte të zbatimit të këtyre detyrimeve, nëse këto fakte kërkohen nga dogana.

Në të gjitha rastet e mësipërme mallrat mund të transportohen me çfarëdolloj mjeti transporti.

Situatat e përshkruara në pikat (a) dhe (b) më sipër, në përgjithësi nuk paraqesin vështirësi, pasi ngarkesa shoqërohet me një dokument të vetëm transporti. Në rastin e trete(c), mund të paraqiten vështirësi.

Për raste si ato të paraqitura tek pika (c) duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Vetëm ngarkesat e shoqëruara nga dokumentacioni përkatës mund të përfitojnë nga kjo dispozitë.
- b) Mallrat e transportuara në këtë mënyrë duhet të jenë gjithnjë nën mbikqyrje doganore. Mallrat gjithashtu mund të ngarkohen apo të shkarkohen gjatë udhëtimit të tyre dhe mbi to mund të kryhen operacione që kanë qëllim mirëmbajtjen dhe ruajtjen e

mallrave në kushte të mira. Këto operacione lejohet të kryhen me kusht që ato të bëhen nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore lokale.

Në të gjitha rastet e trasbarkimit apo magazinimit doganor në territore jashtë zonës së kumulimit është e nevojshme të vërtetohet se ngarkesa që ka dale nga vendi eksportues është e njëjtë me atë që ka mbërritur në vendin importues.

Dokumentacioni i kërkuar mund të jetë një nga tre llojet e përshkruara në nenin 12(2). Në mungesë të një dokumenti të vetëm transporti (psh. bill of lading) autoritete doganore të vendeve nëpër të cilat kanë tranzituar mallrat duhet të mundësojnë një vërtetim dokumentar që tregon se ngarkesa ka qënë gjithë kohës në mbikqyrje, gjatë kohës që ka qënë në territorin e tyre. Një vërtetim i tillë duhet të përmbajë detajet e përshkruara në Nenin 13(2).

Në terma të thjeshtë, një vërtetim i tillë duhet të detajojë historikun e udhëtimit të ngarkesës nëpër territorin e tyre dhe kushtet nën të cilat është kryer mbikqyrja doganore. Ky vërtetim dokumentar njihet si Çertifikatë e mos-manipulimit.

Në mungesë të dokumentave si më sipër, çfarëso dokumenti tjetër thelbësor mund të paraqitet në mbështetje të kërkesës për preferencë (psh. Dokument tregtar etj).

NENI 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese, të dërguara për ekspozim në një vend apo territor tjetër të ndryshëm nga ato të referuara në Nenet 3 dhe 4, dhe të cituara pas ekspozimit për importim në Komunitet ose Shqipëri, përfitojnë në import nga dispozitat e Marrëveshjes, pasi të arrihet që të binden autoritetet doganore që:

(a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga Komuniteti ose Shqipëria në vendin në të cilin bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

(b) produktet janë shitur ose në të kundërt i janë vënë në dispozicion nga ky eksportues një personi në Komunitet ose Shqipëri;

(c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas saj në gjendjen në të cilën ato janë dërguar për ekspozim;

dhe

(d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato u dërguan në ekspozitë, për ndonjë

qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Dëshmia e origjinës duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e Titullit V dhe të jetë depozituar pranë autoriteteve doganore të vëndit importues në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur çmohet e nevojshme, mund të kërkohen të dhëna shtesë dokumentare në lidhje me kushtet e produkteve gjatë ekspozimit.

3. Paragrafi 1 aplikohet për çdo lloj ekspozimi, prezantimi të thjeshtë apo panairi publik tregtar, industrial, bujqësor, ose demonstrime që nuk duhet të jenë organizuar për qëllime private apo ambiente biznesi me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë, dhe gjatë të cilëve produktet i nënshtrohen kontrollit doganor.

KOMENT:

Ky Nen përfshin mallrat origjinues të cilat dërgohen në një ekspozitë publike.

Në rastin e ekspozitave teregatare , industriale apo të zejeve është e rëndësishme që të mund të vërtetohet se mallrat që janë eksportuar për ekspozitë nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim, përpunim që në momentin e eksportit. Një kërkesë tjetër është që mallrat nuk janë përdorur për asnjë qëllim tjetër veç demonstrimit në ekspozitë dhe ato janë ngarkuar gjatë apo menjëherë pas ekspozitës.

Mallrat që janë shitur gjatë apo pas ekspozimit mund të përfitojnë nga origjina preferenciale me kusht që të vërtetohet se:

1. Ato janë dërguar nga njëra palë në një ekspozitë;
2. Eksportuesi i ka shitur ato tek një person në një palë tjetër kontraktuese psh në BE;
3. Janë ngarkuar gjatë apo menjëherë pas ekspozitës, të pandryshuara; dhe
4. Janë përdorur vetëm për qëllim demonstrimi apo ekspozimi që nga momenti i ngarkimit për ekspozitë.

Të kihet parasysh se të gjitha kushtet e këtij Neni duhen plotësuar, përndryshe malli i rikthyer do të konsiderohet si jo-origjinues dhe do të trajtohet si i tillë.

Përfubdimisht, një dokument origjine duhet të bëhet apo lëshohet në përputhje me Nenet përkatëse të Titullit V të Protokollit (shih shpjegimet mbi nenet përkatëse lidhur me dokumentet që vërtetojnë origjinën preferenciale).

TITULLI IV

TËRHEQJA OSE PËRJASHTIMI

NENI 15

Ndalimi i rimbursimit, ose përjashtimeve nga tarifrat doganore

1. Materialet jo origjinuese të përdorura në prodhimin e një produkti origjinues në Komunitet në Shqipëri, ose në një prej vendeve apo territoreve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 për të cilat dëshmia e origjinës është lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e Titullit V nuk do të jenë në Komunitet ose Shqipëri, subjekt rimbursimi apo përjashtim nga tarifrat doganore të çfarëdo lloji.

2. Ndalimi në paragrafin 1 aplikohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, anulim i borxheve ose mos-pagesave, të pjesshme ose tërësore, të tarifave doganore ose detyrimeve të tjera më të njëjtin efekt, të aplikueshme në Komunitet ose në Shqipëri, për materialet e përdorura në prodhim, ku rimbursimet, anulimet e borxheve ose mos-pagimet e tilla aplikohen, shprehimisht ose me efekt, kur produktet e përfuara nga materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen për përdorim të brendshëm atje.

3. Eksportuesi i produkteve mbuluar me dëshmi origjine duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se asnjë rimbursim nuk është bërë në lidhje me materialet jo-origjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha tarifrat doganore ose detyrimet e tjera më të njëjtin efekt të aplikueshme për të tilla materiale, aktualisht kanë qënë paguar.

4. Dispozitat e paragrafeve nga 1 në 3, gjithashtu aplikohen përsa i përket paketimit, brenda kuptimit të Nenit 8(2), plotësuesit, pjesët e këmbimit dhe instrumentet, brenda kuptimit të Nenit 9 dhe produktet në një komplet, brenda kuptimit të Nenit 10, kur përbërës të tillë janë jo-origjinues.

5. Dispozitat e paragrafeve nga 1 në 4, do të aplikohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet Marrëveshja. Për më tepër, nuk përjashtohet aplikimi i ndonjë sistemi të rimbursimit të eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshme për eksportet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

KOMENT

Përpara shpjegimit të dispozitave të këtij Neni, është ndoshta e nevojshme të jepet një shpjegimbi termin ri-imbursim/përrjashtim(draëback). Kur mallrat mbërrijnë në një vend, ato i nënshtrohen pagesës së detyrimit doganor. Përpara se mallrat të çlirohen duhet bërë pagesa e këtyre detyrimeve.

Ri-imbursim/ përrjashtim nënkupton përrjashtimin nga detyrimet apo riimbursimin e detyrimeve doganore për materialet e përdorura për prodhimin e një produkti destinuar për eksport.

Qëllimi i këtij Neni është që të parandalohet “riimbursimi/përrjashtimi” nga detyrimet doganore për mallrat jo-origjinuese të përdorura në përpunimin /prodhimin e një produkti origjinues.**Të gjitha detyrimet doganore të parashikuara, duhet të paguhen për mallrat jo-origjinuese dhe në asnjë rast nuk mund të ri-imbursohen dhe në rast se autoritetet doganore e kërkojnë, atyre duhet t’u paraqiten fakte përrkatëse dhe dokumentacion lidhur sa më sipër.**

Ky Nen ka të bëjë me rastet e Rregjimit të përpunimit Aktiv(me pezullim apo ri-imbursim), dhe zbatohet i lidhur me Nenin 231 te Kodit Doganor të RSH.

NOTE SHPJEGUESE:

Dispozitat e ndalimit të ri-imbursimit apo përrjashtimit zbatohet kur për produktin final kërkohet nga Dega Doganore lëshimi, apo lëshohet nga eksportuesi, një dokument që vërteton origjinën preferenciale.

Shembull:

Ananasi nga Kosta Rika(HS kapitulli 8) dhe sheqeri origjinues ne BE (HS 1701) importohet në Shqipëri ku prodhohet lëng ananasi(HS 2009). Produkti origjinues eksportohet në Kosovë.

Nëse për lëngun e ananasit kërkohet lëshimi i një çertifikate Lëvizjeje EUR.1 dhe nëse ky produkt përfiton në Kosove tarifë preferenciale sipas CEFTA, për ananasin dhe sheqerin e importuar (pavarësisht rregjimit nën të cilin është vendosur) duhet paguar taksa doganore e importit, ose në rast RPA , me ri-imbursim, nuk duhet ri-imbursuar taksa doganore e importit).

TITULLI V

Vërtetimi i Origjinës

Titulli V i protokollit përbëhet nga 16 Nene. Këto Nene përshkruajnë llojet e dokumentave që mundësojnë vërtetimin e origjinës preferenciale dhe parashtrojnë kushtet dhe procedurat për lëshimin e këtyre dokumenteve.

Nëse origjina mund të përshkruhet si “nënshtetsia ekonomike” e mallrave, dokumentat që vërtetojnë origjinën mund të konsiderohen si “pasaporta” apo “karta e identitetit” e mallrave. Thjesht këtë gjë bëjnë dokumentat e origjinës, ato vërtetojnë që mallrat e shoqëruara prej tyre kanë plotësuar të gjitha kërkesat mbi origjinën të përshkruara në Nenet 5 deri 7 përfshire dhe të gjitha dispozitat e tjera përkatëse mbi origjinën, në veçanti rregullin e ndalimit të ri-imbursimeve dhe përjashtimeve parashikuar në nenin 15.

Dokumentet që vërtetojnë origjinën preferenciale janë: Çertifikata e Lëvizjes EUR.1, Çertifikata e Lëvizjes EUR.1 për CEFTA, Çertifikata e Lëvizjes EUR-MED, “Deklarata faturë, ” “Deklarata Faturë për CEFTA” dhe “Deklarat faturë EUR-MED”.

Njëri prej këtyre dokumenteve duhet të paraqitet në doganë në mbështetje të kërkesës për preferencë.

NENI 16

Kërkesa të përgjithëshme

1. Produktet origjinuese në Komunitet, gjatë importimit në Shqipëri, dhe produktet origjinuese në Shqipëri gjatë importimit në Komunitet, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje me paraqitjen e njëjës nga dokumentat e mëposhtme:

(a) një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një model i e së cilës tregohet në Aneksin III; ose

(b) në rastet e specifikuara në Nenin 22(1), të një deklaratë, referuar rrjedhimisht si “deklarate fature”, dhënë nga eksportuesi në një faturë, një notë dërguese ose dokument tjetër tregtar i cili përshkruan produktet përkatëse në detaje të mjaftueshme për t’u identifikuar; teksti i deklaratës faturë paraqitet në Shtojcën IV.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e këtij Protokolli, përsa i

takon rasteve të specifikuara në Nenin 27, përfitojnë nga kjo Marrëveshje, pa qënë e nevojshme të depozitohet ndonjë nga dokumentet e përmendur më sipër.

KOMENT

Dhënia e trajtimit preferencial kushtëzohet nga paraqitja e një dokumenti të vlefshëm të origjinës preferenciale. Dokumenti i kërkuar është një Çertifikatë Lëvizjeje EUR.1, një Deklaratë –faturë, një çertifikatë Lëvizjeje EUR-MED, ose një Deklaratë-Fature EUR-MED.

Në rastet e pakove të vogla që dërgohen nga një person tek tjetri apo mallrat të cilat janë bagazh personal i udhetuesve, këto përjashtohen nga detyrimi për të paraqitur një vërtetim origjine, Kushtet e parashikuara për këto raste trajtohen në nenin 27.

Përpara se të fillohen hap[at për të plotësuar një dokument të orgjines preferenciale është e nevojshme të përcaktohet origjina e mallit sipas Neneve të sipërpërmendur mbi Rregullat e Origjinës. Duhet të përcaktohet nëse mallrat janë tërësisht të përftuar apo të punuar/përpunuar në mënyrë të mjaftueshme, nëse janë paguar tërësisht të gjitha taksat doganore të parashikuara, dhe nëse është gjetur përshkrimi i saktë tarifor i mallit.

NENI 17

Procedurat për lëshimin e çertifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1

- 1. Një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues mbështetur në aplikimin e bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.*
- 2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar plotësojnë të dyja dokumentet, çertifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe formularin e aplikimit, modelet e të cilave tregohen në Shtojcën III. Këta formularë plotësohen në një nga gjuhët në të cilat është hartuar kjo Marrëveshje dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vëndas të vëndit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato plotësohen me bojë me gërma kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në kutinë e rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, një vizë horizontale duhet të hiqet poshtë vijës së fundit së*

përshkrimit, lart hapësirës boshe.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1

përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vëndit eksportues ku certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 është lëshuar, të gjitha dokumentat e nevojëshme që provojnë statusin origjinues të produktit në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

4. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të një

Shteti Antar ose të Shqipërisë nëse produktet në fjalë konsiderohen me origjinë në

Komunitet ose në Shqipëri, apo në një prej vendeve dhe territoreve të tjera të përcaktuara në Nenet 3 dhe 4, dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokolli.

5. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1

ndërmarrin masa apo hapa të nevojëshem për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo evidencë apo të ndërmarrin çfarëdo lloj inspektimi të llogarive financiare të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojëshem. Autoritetet doganore në lëshimin e certifikatave të tilla gjithashtu sigurojnë që formularët referuar paragrafit 2 janë plotësuar në mënyrën e duhur. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa të rreme.

6. Data e lëshimit të një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 tregohet në Kutinë 11 të certifikatës.

7. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore dhe vihet në dispozicion eksportuesit sapo të kryhet ose sigurohet eksportimi në fjalë.

KOMENT:

Gjëja e parë që duhet kuptuar mbi lëshimin e një EUR.1 apo EUR-MED është se, përpara se dogana ta lëshojë atë, eksportuesi apo axhenti i tij kanë përgjegjësinë për ti prezantuar doganës informacionin korrekt tek aplikimi për këtë certifikatë lëvizjeje. Informacioni i kërkuar do të përfshijë disa apo të gjitha të mëposhtmet:

-klasifikimin tarifor të mallit;

- punimin apo perpunimin e kryer mbi mallin;
- vërtetimin e origjinës mbi çdo material apo pjesë të përdorur;
- të dhëna mbi materialet apo pjesët jo-origjinuese të përdurura në prodhimin e produktit final duke përfshirë klasifikimin e tyre tarifor;
- vërtetim mbi pagesën e detyrimeve doganore për materialet jo-origjinues të përdorura;
- çdo lloj dokumenti tjetër të nevojshëm që mund të kërkohet nga dogana.

Neni 17(2) përshkruan qartë sesi duhet plotësuar kërkesa dhe çertifikata dhe aplikimi për çertifikatë.

Çertifikata i jepet eksportuesit ndërsa aplikimi mbahet nga autoritetet doganore së bashku me dokumentet e tjerë që kanë shërbyer për lëshimin e çertifikatës. Në faqen e pasme të aplikimit eksportuesi duhet të specifikojë arsyet se përse ai konsideron se mallrat në fjalë përmbushin kriteret e kërkuara për origjinë preferenciale.

Eksportuesi duhet të depozitojë dokumentat e ndryshme mbi të cilat është bazuar aplikimi (psh. kopje të EUR.1 /EUR-MED të mallrave të importuara dhe trupëzuara në produktin final, fatura, deklarata doganore, deklarata nga prodhuesit etj).

NENI 18

Çertifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1

të lëshuara në retrospektivë(a-posteriori)

1. Pavarësisht nga Neni 17(7), një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 në raste të veçanta mund të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilëve iu referohet, nëse:

(a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta;

ose

(b) është demonstruar pranë autoriteteve doganore që një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 është lëshuar por që për arsye teknike nuk është pranuar gjatë importimit.

2. Për zbatimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve për të cilat çertifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet, dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.
3. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 në retrospektivë (a posteriori) vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjes korresponduese.
4. Çertifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar në retrospektivë duhet të mbyllet me frazën e mëposhtme në anglisht: "ISSUED RETROSPECTIVELY",
5. Faza referuar në paragrafin 4 vendoset në kutinë 7 "Vërejtje" të çertifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

KOMENT:

Neni 18 parashikon që ekzistojnë raste kur dogana mund të lëshojë një EUR.1 ose EUR-MED pasi është kryer eksporti. Aplikanti duhet të bindë doganen se arsyet për kërkimin e lëshimit të një certificate a-posteriori (pasi është bërë eksporti) janë justifikuese. Të dhënat mbi datën dhe vendin e eksportit të kryer duhet të shoqërojnë aplikimin për çertifikatën, Këto të dhëna mbi datën dhe vendin e eksportit të kryer duhet të shoqërojnë aplikimin për çertifikatën. Këto të dhëna duhet të jenë të njëjta me të dhënat që ekzistojnë në doganë.

NENI 19

Leshimi i dublikates te çertifikates se qarkullimit te mallrave EUR.1

1. *Ne rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi te nje eertifikate qarkullimi mallrash EUR.1, eksportuesi mund te aplikojë tek autoritetet doganore te cilat e kane leshuar ate per nje dublikate qe behet ne baze te dokumenteve te eksportit ne zoterim te tyre.*
2. *Dublikata e leshuar ne kete menyre duhet te mbyllet me fjalen e meposhtme ne anglisht: "DUPLICATE"*
3. *Shenimi I referuar ne paragrafin 2 vendoset ne kutine (7) "Verejtje" te dublikates te çertifikates se qarkullimit te mallrave EUR.1.*
4. *Dublikata e cila duhet te permbaje edhe daten e leshimit te çertifikates se qarkullimit te mallrave EUR.1, hyn ne fuqi nga kjo date .*

KOMENT:

Ne rastet kur origjinali i certifikates se qarkullimit te mallrave EUR.1 apo EUR-MED ka humbur apo eshte shkaterruar, subjekti mund te kerkoje nga autoritetet doganore te vendit eksportues leshimin e nje certifikate dublikate. **Dublikata eshte nje kopje ekzakte e origjinalit.** Duhet te mbuloje te njejtat mallra si certifikata origjinale, me te gjitha te dhenat e nevojshme. Certifikata dublikate duhet te mbaje gjithnje shenimin "DUPLICATE" ne kutine 7. Ky shenim behet ne anglisht.

NENI 22

Kushtet per berjen e nje Deklarate Fature

1. *Nje deklarate fature, siç referohet ne Nenin 16(1)(b), mund te behet:*
 - (a) *nga nje eksportues i miratuar ne kuptimin e Nenit 23,*
 - ose*
 - (b) *nga nje eksportues I ndonje dergese te perbere nga nje ose me shume paketime qe permbajne produkte origjinuese vlere totale e te cilave nuk I kalon 6 000 Euro.*
2. *Nje deklarate fature, mund te behet nese produktet ne fjale konsiderohen si produkte origjinuese ne Komunitet, ne Shqiperi ose ne nje prej vendeve apo territoreve te tjera te referuara ne Nenet 3 dhe 4 dhe kur permbushen te gjitha kerkesat e tjera te ketij Protokolli.*
3. *Eksportuesi qe ben nje deklarate fature duhet te pergatitet te paraqese ne çdo kohe, me kerkesen e autoriteteve doganore te vendit eksportues, te gjitha dokumentet e nevojshme qe provojne statusin origjinues te produkteve ne fjale si dhe plotesimin e kerkesave te tjera te ketij Protokolli.*
4. *Nje deklarate fature duhet te behet nga eksportuesi duke shtypur stampuar, ose printuar mbi faturen, noten shperndarese ose ndonje dokument tjeter tregtar, nje deklarim teksti i se ciles jepet ne Shtojcen IV, duke perdorur nje nga versionet gjuhesore te percaktuara ne ate Shtojce dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit vendas te vendit eksportues. Nese deklarata eshte e shkruar me dore, duhet te shkruhet me boje ne germa kapitale.*
5. *Deklaratat fature duhet te kene firmen origjinale te eksportuesit te shkruar me dore. Sidoqofte, nje eksportuesi te aprovuat sipas kuptimit te Nenit 23, nuk do t'i kerkohet te nenshkruaje deklarata te tilla me kusht qe t'i paraqese autoriteteve doganore te vendit eksportues nje deklarate me shkrim ku merr persiper me pergjegjesi te plote per çfaredo deklarate fature e cila e identifikon ate njesoj si te ishte nenshkruar me shkrim dore prej tij.*

6. Nje deklarate fature mund te behet nga eksportuesi kur produktet te cilave ajo u referohet eksportohen, ose mbas eksportimit me kusht qe ajo te jete paraqitur ne vendin importues jo me vone se dy vjet mbas importimit te produkteve te cilave ajo u referohet.

KOMENT:

Megjithese te gjitha mallrat pre te cilat kerkohej trajtim preferencial duhet te shoqerohen me vertetim origjine preferenciale, eshte e mundur qe te paraqitet nje vertetim origjine I ndryshem nga EUR.1/EUR-MED kur plotesohen disa kushte te caktuara.

Mund te paraqitet si vertetim I origjines preferenciale, nje deklarate faturene rastin (1) nje Eksportuesi te Miratuar, pavaresisht vleres se mallit, ose (2) nga nje eksportues, kur vlera e totale e mallit nuk i kalon 6 000 Euro.

Teksi standart qe duhet perdorur ne Deklaraten Fature eshte:

“The exporter of the products covered by this document (customs authorization No ...) declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of ...preferential origin.”.

Ose ne rastin e Deklarates fature EUR-MED dhe Deklarates fature CEFTA

“The exporter of the products covered by this document (customs authorization No ...) declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of ...preferential origin.”.

- cumulation applied with....(emri I vendit/vendeve)

- no cumulation applied

Ne MTL-te perkatese ne fuqi parashikohen te gjitha versionet gjuhesore te tekstit te Deklarates fature.

Deklarimet ‘*cumulation applied with...*’ dhe ‘*no cumulation applied*’ – duhet te jene ne Anglisht.

NENI 23

Eksportuesi i Miratuar

1. Autoritetet doganore te vendit eksportues mund te autorizojne çdo eksportues, ketu e me pas tereferuar si “eksportuesi i aprovuar”, qe ben dergesa te shpeshta te mallrave sipas kesaj

Marreveshjeje, te beje deklarata fature pavaresisht nga vlera e produkteve ne fjale. Nje eksportues qe kerkon nje autorizim te tille, duhet te paraqese sipas kerkesave te autoriteteve doganore, te gjitha garancitee nevojshme per te vertetuar statusin origjinues te produkteve si dhe plotesimin e kerkesave te tjera te ketij Protokolli.

- 2. Autoritetet doganore mund te japin statusin e eksportuesit te miratuar kundrejt cfaredo kushtesh qe gjykohen te pershtatshme prej tyre.*
- 3. Autoritetet doganore i japin eksportuesit te miratuar nje numer autorizimi doganor i cili duhet te shfaqet ne deklaraten fature.*
- 4. Autoritetet doganore monitorojne perdorimin e autorizimeve nga ana e eksportuesit te aprovuar.*
- 5. Autoritetet doganore mund te terheqin autorizimin ne çdo kohe. Ato mund ta bejne kete kur Eksportuesi i Miratuar nuk ofron me garancite referuar ne paragrafin 1, si dhe nuk permbush me kerkesat referuar paragrafit 2, ose kur kryen perdorim jo korrekt te autorizimit.*

KOMENT:

Nje eksportuesi i miratuar mund te jete prodhues ose thjesht eksportues i mallrave.

Eksportuesi i Miratuar eshte nje eksportues I cili I ka permbushur kriteret e vendosura nga autoritetet doganore dhe I eshte dhene e drejta nga dogana qe te vertetoje origjinen preferenciale nepermjet Deklarates Fature. Rregullorja 01/2009 parashikon te gjitha hapat e qe duhen ndjekur ne menyre qe nje eksportues te mund te marre nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Statusin e Eksportuesit te Miratuar nepermjet Autorizimit perkates.

NENI 24

Vlefshmeria e deshmise se origjines

- 1. Deshmia e origjines eshte e vlefshme per kater muaj nga data e leshimit ne vendin eksportues dhe duhet depozituar brenda kesaj periudhe tek autoritetet doganore te vendit importues.*
- 2. Deshmitet e origjines te cilat depozitohen prane autoriteteve doganore te vendit importues pas dates se fundit per paraqitje, e specifikuar ne paragrafin 1, mund te pranohen per qellim te aplikimit te trajtimit preferencial, kur pamundesia per depozitim e ketyre dokumenteve deri ne daten perfundimtare eshte shkaktuar nga rrethana te jashtezakonshme.*
- 3. Ne rastet e tjera te depozitimeve mjaft te vonuara, autoritetet doganore te vendit importues mund ta pranojne deshmine e origjines kur produktet jane depozituar perpara dates perfundimtare.*

KOMENT:

Dokumentat qe vertetojne origjinen kane nje afat skadence kater muaj. Ky afat fillon ne daten e leshimit/prodhimit dhe duhet te paraqitet ne dogane Brenda ketij afati kater mujor.

Gjithesesi, Neni 24 lejon pranimin e dokumentit te origjines edhe pas kater muajsh, ne rrethana te vecanta.

NENI 25

Depozitimi i deshmise se origjines

Deshmia e origjines duhet te paraqitet prane autoriteteve doganore te vendit importues ne perputhje te plote me procedurat qe aplikohen ne ate vend. Keto autoritete mund te kerkojne nje perkthim te deshmise se origjines dhe gjithashtu mund te kerkojne deklaraten e importit qe duhet t'i bashkengjitet nje deklarimi nga importuesi qe verteton se produktet plotesojne kushtet e kerkuara per zbatimin e kesaj Marreveshjeje.

KOMENT:

Ky Nen u jep te drejte Autoriteteve Doganore te vendit importues te kerkojne nga importuesi perkthimin e Dokumenteve qe vertetojne origjinen preferenciale.

NENI 26

Importimet me dergese te pare

Kur, me kerkesen e importuesit dhe me kushtet e parashtruara nga autoritetet doganore te vendit importues, produktet e ndara ose jo te grupuara ne kuptimin e Rregullit te Pergjithshem 2(a) te Sistemit te Harmonizuar, qe eshte ne Seksionin XVI dhe XVII apo ne Kreret Nr. 7308 dhe 9406, jane importuar me dergese te pare, nje deshmi e origjines per produkte te tilla duhet te paraqitet prane autoriteteve doganore gjate importimit te dergeses se pare.

KOMENT:

Neni 26 i jep mundesi importuesit te importoje nje mall te madh, te ndare ne ngarkesa te vogla. Keto ngarkesa te ndara mund te mbulohen nga vetem nje vertetim origjine preferenciale i cili

paraqitet gjate importit te ngarkeses se pare. Ky Nen mbulon kryesisht fabrika apo linja prodhimi. Autoritetet Doganore te vendit importues, kane te drejte te pranojne kerkesen, kushtezuar nga çfaredo konditash qe ato mendojne se duhen plotesuar.

NENI 27

Perjashtimet nga deshmia e origjines

- 1. Produktet e derguara ne paketime te vogla nga persona private tek personat private ose qe jane pjese e bagazheve personale te udhetareve, pranohen si produkte origjinuese pa qene nevoja per te paraqitur deshmine e origjines, nese sigurohet se keto produkte nuk jane importuar per qellime tregtie dhe jane deklaruar se plotesojne kerkesat e ketij Protokolli dhe kur nuk ka dyshime rreth vertetesise se nje deklarimi te tille. Ne rastin e produkteve te derguara me poste, kjo deklarate mund te behet ne deklarimin doganor CN22/CN23 ose ne nje flete te veçante letre qe i bashkengjitet atij dokumenti.*
- 2. Importet te cilat jane te rastesishme dhe perbejne vetem produkte per perdorim personal nga marresi ose udhetari ose familjaret e tyre, nuk konsiderohen si importe per qellime tregtie kur nisur nga pikepamja e natyres dhe sasise se produkteve eshte evidente qe nuk ka qellime tregtie per to.*
- 3. Per me teper, vlera totale e ketyre produkteve nuk duhet te tejkalojne 500 Euro ne rastin e pakove te vogla ose 1 200 Euro ne rastin e produkteve qe jane pjese e bagazheve personale te udhetareve.*

KOMENT:

Pako te vogla te derguara me poste nga nje individ privat tek tjetri lejohen te hyjne ne vend pa patur nevoje per vertetim origjine. Keto dergesa postare kufizohen deri ne vleren 500 Euro.

Nje leshim i ngjashem zbatohet edhe per bagazhet personale te udhetareve deri ne vleften 1200 Euro.

Dispozitat e mesiperme zbatohen vetem nese:

- 1) keto produkte nuk importohen per qellime tregtie;
- 2) eshte deklaruar se keto mallra plotesojne rregullat e ketij Protokolli;
- 3) nuk ekzistojne dyshime per vertetesine e deklarimit.

NENI 28

Dokumentet mbeshtetese

Dokumentet referuar ne Nenin 17(3) dhe 22(3) qe perdoren per qellime vertetimi se produktet e shoqeruara me nje çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1 ose nje deklarate fature, mund te konsiderohen si produkte origjinuese ne Komunitet, ne Shqiperi, ose ne nje prej vendeve apo territoreve te tjera referuar ne Nenet 3 dhe 4 dhe qe plotesojne te gjitha kerkesat e tjera te ketij Protokolli, mund te jene si me poshte:

- (a) prove e drejtperdrejte e proceseve te kryera nga eksportuesi ose furnizuesi per te perftuar produktet ne fjale, qe mbahen per shembull ne llogarite ose ne librat e kontabilitetit te tij te brendshem;*
- (b) dokumentet qe vertetojne statusin e origjines se materialeve te perdorura, te leshuara ose te bera ne Komunitet ose ne Shqiperi ku keto dokumente perdoren ne perputhje me ligjin vendas;*
- (c) dokumentet qe vertetojne punimet ose perpunimet e materialeve ne Komunitet ose ne Shqiperi, te leshuara ose te bera ne Komunitet ose ne Shqiperi, ku keto dokumente perdoren ne perputhje me ligjin vendas;*
- (d) çertifikata te qarkullimit te mallrave EUR.1 ose deklarata fature qe vertetojne statusin e origjines se materialeve te perdorura, te leshuara ose te bera ne Komunitet ose ne Shqiperi ne perputhje me kete Protokoll ose ne nje prej vendeve apo territoreve te tjera te referuara ne Nenet 3 dhe 4, ne perputhje me rregullat e origjines qe jane identike me rregullat e ketij Protokolli.*
- (e) prova te pershtatshme ne lidhje me punimet apo perpunimet jashte Komunitetit apo Shqiperise me ane te aplikimit te Nenit 12, qe verteton se jane permbushur kerkesat e atij Neni.*

KOMENT:

Kur paraqitet nje kerkese per leshimin e EUR/EUR-MED apo kur leshon vete nje Deklarate Fature, eksportuesi duhet te jete ne gjendje ne çdo moment ti paraqese doganes dokumentat mbeshtetes per kete qellim. Keto dokumenta mbeshtetes ndihmojne doganen per te konfirmuar statusin origjinues te mallrave pe te cilat eshte kerkuar EUR/EUR-MED. Ky Nen paraqet shembuj te dokumentave mbeshtetes.

NENI 29

Ruajtja e deshmise se origjines dhe e dokumenteve mbeshtetese

1. *Eksportuesi qe aplikon per leshimin e nje çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1 duhet t'i mbaje dokumentet referuar ne Nenin 17 (3) per te pakten tre vjet.*
2. *Eksportuesi qe ben nje deklarate fature duhet te mbaje per te pakten tre vjet nje kopje te kesaj deklarate fature si dhe dokumentet referuar ne Nenin 22(3).*
3. *Autoritetet doganore te vendit eksportues qe leshojne nje çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1 duhet te mbajne per te pakten tre vjet formularin e aplikimit referuar ne Nenin 17(2).*
4. *Autoritetet doganore te vendit importues duhet te mbajne per te pakten tre vjet çertifikatat e qarkullimit te mallrave EUR.1 si dhe deklaratat fature qe iu dorezohen atyre.*

KOMENT:

Per qellime te ndryshme, mund te jete I nevojshem ri-kontrollimi I dokumentave qe kane shoqeruar nje import/eksport. Per kete arsye, dokumentat jane te detyruara te ruhen per nje peridhe minimumi tre vjetesh.

NENI 30

Mosperpathjet dhe gabimet formale

1. *Ne rast se gjenden mosperpathje te vogla ne deklarimet e bera ne deshmine e origjines dhe ato te bera ne dokumentat e paraqitura ne zyren doganore per qellime te kryerjes se formaliteteve per importimin e produkteve, kjo nuk e ben te pavlefshme deshmine e origjines nese eshte evidentuar se ky dokument i korrespondon produkteve te paraqitura..*
2. *Gabimet formale te dukshme te tilla si gabime gjate shtypjes ne deshmine e origjines nuk do te behen shkas qe ky dokument te anulohet, nese keto gabime nuk jane te tilla qe te krijojne dyshime ne lidhje me korrektesine e deklarimit te bere ne ate dokument.*

KOMENT:

Ky Nen mbulon situatat kur ne Dokumentat e origjines dallohen gabime minimale. **Ne kete konteks fjala “gabime” perjashton dhenien e qellimshme te informacionit fals.**

Gjithesesi, **eshte kompetence e autoritetit doganor te vendit importues vendimi** nese keto gabime jane apo jo te mjaftueshme per te mos e pranuar dokumentin e origjines preferenciale.

TITULLI VI

RREGULLIMET PER BASHKEPUNIMIN ADMINISTRATIV

Per respektimin e rregullave te origjines dhe trajtimin preferencial te mallrave, eshte I domosdoshem nje nivel I larte bashkepunimi ndermjet Autoriteteve Doganore. Ky Seksion I Protokollit trajton nivelin e synuar te bashkepunimit ndermjet Autoriteteve Doganore me qellim verifikimin e Dokumenteve qe Vertetojne Origjinen preferenciale.

NENI 32

Bashkepunimi i ndersjellte

- 1. Autoritetet doganore te Shteteve Anetare te Komunitetit dhe Shqiperisei sigurojne njera-tjetres, nepermjet Komisionit te Komuniteteve Evropiane, kopje te llojit te vulave te perdorura ne zyrat e tyre doganore per leshimin e certifikatave te qarkullimit te mallrave EUR.1 dhe adresat e autoriteteve doganore pergjegjese per verifikimin e ketyre certifikatave dhe deklaratave fature.*
- 2. Me qellim aplikimin e duhur te ketij Protokolli, Komuniteti dhe Shqiperia duhet te ndihmojne njera-tjetren, nepermjet administratave doganore kompetente, ne kontrollin e origjinalitetit te certifikatave te qarkullimit te mallrave EUR.1 ose te deklaratave fature, si dhe korrektesine e informacionit te dhene ne keto dokumente.*

KOMENT:

Me qellim garantimin e manaxhimit te sakte te Rregullsve te Origjines, administratat doganore bien dakort te asistojne njera-tjetren dhe te bashkepunojne me njera-tjetren. Neni 32 paraqet detyrimin qe kane administratat doganorene kete drejtim.

Nje nga fushat e abuzimit mund te jete falsifikimi I EUR.1. Pe te reduktuar leshimin e dokumenteve te falsifikuara, palet bien dakort qe ti japin njera-tjetres mostra te vulave te perdorura per leshimin e EUR/EUR-MED.

Autoritet Doganore te Paleve Kontraktuese jane gjithashtu te detyruara te asistojne njera-tjetren per te kontrolluar autenticitetin e certifikatave EUR/EUR-MED te leshuara prej tyre si dhe autenticitetin dhe rregullshmerine e Deklaratave fature, si dhe te çdo dokumenti shoqerues te tyre. Verifikimit kryen kur autoritetet doganore te vendit importues bejne nje kerkese zyrtare prane autoriteteve doganore te vendit importues lidhur me verifikimin e dokumnetave qe vertetojne origjinen preferenciale, ose me iniciative te autoriteteve doganore te vendit eksportues.

NENI 33

Verifikimi i deshmive te origjines

- 1. Verifikimet e duhura te deshmive te origjines duhet te kryhen me metoden e zgjedhjes se rastesishme ose sa here qe autoritetet doganore te vendit importues kane dyshime te arsyeshme per origjinalitetin e dokumenteve te tilla, per statusin e origjines se produkteve perkatese ose per permbushjen e kerkesave te tjera te ketij Protokolli.*
- 2. Per qellimet e zbatimit te dispozitave te paragrafit 1, autoritetet doganore te vendit importues duhet t'ia kthejne certifikaten e qarkullimit te mallrave EUR.1 si dhe deklaraten fature, ne rast se eshte paraqitur, ose nje kopje te ketyre dokumenteve, autoriteteve doganore te vendit eksportues, duke u dhene, atehere kur eshte e nevojshme, arsyet per verifikimin. Çdo dokument dhe informacion i marre i cili sugjeron se informacioni i dhene mbi deshmive e origjines eshte jokorrekt, duhet t'i bashkengjitet kerkeses per verifikim.*
- 3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore te vendit eksportues. Per kete qellim, ato kane te drejte te kerkojne çfaredo dokumenti dhe te kryejne çfaredo inspektim te llogarive te eksportuesit ose çdo lloj kontrolli qe konsiderohet i nevojshem.*
- 4. Ne rast se autoritetet doganore te vendit importues vendosin te pezullojne perkohesisht dhenien e trajtimit preferencial per produktet perkatese, nderkohe qe presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundesia per te mos i bllokuar produktet, vetem ne rastet e marrjes se ndonje mase sigurie kur gjykohet e nevojshme.*
- 5. Autoritetet doganore qe kerkojne verifikimin duhet te informohen per rezultatet e ketij verifikimi sa me shpejt te jete e mundur. Keto rezultate duhet te tregojne qarte nese dokumentet*

jane origjinale dhe nese produktet perkatese mund te konsiderohen si produkte origjinuese ne Komunitet, ne Shqiperi, apo ne ndonje vend apo territor tjeter referuar ne Nenet 3 dhe 4, dhe qe plotesojne kerkesat e tjera te ketij Protokolli.

6. *Ne rast se per nje dyshim te arsyeshem, nuk vjen pergjigje brenda dhjete muajve nga data e kerkeses se verifikimit, ose ne qofte se pergjigjja nuk permban informacion te mjaftueshem per te percaktuar origjinalitetin e dokumentit ne fjale ose origjinen e vertete te produkteve, autoritetet doganore kerkuese te verifikimit, me perjashtim te rrethanave te jashtezakonshme, refuzojne dhenien e trajtimit preferencial.*

KOMENT:

Ne kuadrin e detyrimit qe kane autoritetet doganore te paleve kontarktuese per te asistuar njera-tjetren ne manaxhimin e rregullave te origjines, Neni 33 paraqet menyren e bashkepunimit dhe metoden e kryerjes se verifikimeve.

NENI 34

Zgjidhja e mosmarreshjeve

Kur ka mosmarreshje lidhur me procedurat verifikuese te Nenit 33, te cilat nuk mund te zgjidhen mes autoriteteve doganore qe kerkojne verifikimin dhe autoriteteve doganore pergjegjese per kryerjen e ketij verifikimi, ose kur ato ngrene nje ceshtje lidhur me interpretimin e ketij Protokolli, keto mosmarreshje duhet t'i paraqiten Komitetit te Stabilizim-Asocimit.

Ne te gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarreshjeve ndermjet importuesit dhe autoriteteve doganore te vendit importues behet ne baze te legjislacionin te vendit importues.

SHPJEGIM:

Ne nje sitem te tille kompleks shkembimesh tregtare si ai ndermeje Bashkimit Evropian dhe vendeve partnere, mund te lindin mosmarreshje. Kur ka situata te tilla ndermjet autoriteteve doganore te vendit importues dhe autoriteteve doganore te vendit eksportues, ato do te shtrohen prane Komitetit te Stabilizim Asocijimit.

NENI 35

Penalitetet

Penalitetet vendosen per çdo person qe ploteson ose shkakton plotesimin e nje dokumenti qe permban informacion jokorrekt, me qellimin per te perfituar trajtim preferencial per produktet.

SHPJEGIM:

Subjektet duhet te jene teresisht te sigurt mbi vertetesine e informacionit qe paraqesin prane doganes lidhur me origjinen preferenciale dhe perfitimin e trajtimit preferencial bazuar tek kjo origjine.

TITULLI VIII

DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

NENI 39

Amendimet e Protokollit

Keshilli i Stabilizim-Asociimit mund te vendose per te amenduar dispozita te ketij Protokolli.

